



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
SENATI

Rr. "Nënë Tereza" Nr.4, Tiranë

Tel/Fax:+355 227914

V E N D I M

Nr.21, datë 17.10.2013

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E SENATIT NR.11, DATË 23.12.2011

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9741, datë 21/05/2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin Nr. 14, datë 28.03.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Senati Akademik i Universitetit Politeknik,

VENDOSI:

1.Në Vendimin e Senatit Nr.11, datë 23.12.2011 të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1.Pika 1 formulohet si më poshtë:

Lista e testeve të gjuhës angleze, të njohura nga Universiteti Politeknik, në zbatim të Udhëzimit Nr. 14, datë 28.03.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës është si më poshte:

- Cambridge ESOL-University of Cambridge Examination
- IELTS-International English Language Testing System
- TOEFL-Test of English as a Foreign Language
- TOEIC- Test of English for International Language
- Michigan-Test
- PTE General-Pearson Test of English General

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

2.1 Klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe i niveleve të kompetencave gjuhësore do të bëhet sipas Kuadrit të Përbashket Europian të referencave për gjuhët , përcaktuar në shtojcën Nr. 2 të Udhëzimit Nr. 14, datë 28.03.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Niveli minimal i pranueshëm për kompetencën gjuhësore do të jetë ai i përcaktuar në Vendimin Nr. 29 i Rektoratit , datë 7.03.2013.

2.2. Procedurat dhe modalitetet për testet do të jenë në përputhje me Ligjin Nr. 9741, datë 21/05/2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe përcaktimet e Udhëzimit Nr. 14, datë 28.03.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Akademik Jorgaq KACANI